UNOPS Prot.no. 161023/02

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1262/1 Prot. Tiranë, më dt. 12.10.2023

Lënda: Përcillet **Vendimi Nr. 510, datë 03.10.2023 i KKTKM-së**

ZYRAT E UNOPS
Rruga "Skënderbej", god.Gurten , kati 3,Tiranë

Për dijeni:

MINISTRIA E KULTURËS
Rr."Aleksandër Moisiu", Nr.76, Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË KULTURËS KOMBËTARE, TIRANË
Rr. "Naim Frashëri", Godina Nr. 1, Mozaiku i Tiranës, Shqipëri

BASHKISË DURRËS
Adresa: Sheshi "Liria", Durrës

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në mbledhjen e datës **03.10.2023**, mori **Vendimin nr. 510**, në përputhje me Ligjin Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", nenin 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale,* Urdhrin Nr. 223, datë 03.07.2021 *"Për miratimin e Rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të saj*".

Lutemi gjeni bashkëlidhur kopje të vendimit të sipërcituar.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I KKTKM
Klesta QIRICI

Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu" Nr. 76, ish-Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri,
Email:info@iktk.gov.al, www.iktk.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr.1762 Prot. Tiranë, më datë 03.10.2023

VENDIM
Nr. 510, datë 03.10.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "*Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë*", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "*Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale*", Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 "*Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj*", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 03.10.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit *"Restaurimi i pikturës murale në Kishën e Shna'Ndoit, Kepi i Rodonit"*, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues ATELIER 4 dhe zhvillues **ZYRA UNOPS NË SHQIPËRI;**
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për Trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", datë 17.05.2018, neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Klesta QIRICI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE SEKRETARIA TEKNIKE TIRANË MINISTRIA E KULTURËS

Adresa: Rr. "Aleksandër Moisiu", Nr.76, ish Kinostudio "Shqipëria e Re", Tiranë, Shqipëri,
Email: info@iktk.gov.al; www.iktk.gov.al